



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA GRAMSH
DREJTORIA E PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT TE TERRITORIT

RELACION TEKNIK

“PËRMIRËSIMI I KUSHTEVE TË KOMUNITETIT EGJYPTIAN”

BASHKIA GRAMSH”

Ky projekt parashikon rikonstruksimin e pjesshëm të banesave të komunitetit egjyptian në qytetin e Gramshit, të përqëndruar në territorin e bashkisë Qëndër si edhe në fshatin Pishaj, të Njwsisw Administrative Pishaj, Njwsisw mw të afërt me bashkinë Gramsh.

Për pjesën më të madhe të këtyre banesave, nevoja për financim për rikonstruksimin e tyre është më e madhe se fondi i përcaktuar dhe nisur nga kjo (në bashkërendim me banorët), projekti ynë parashikon kryerjen e punimeve që banorët nuk mund t’i realizojnë vetë, siç janë ndërtimi i çatave të reja, tavanëve, rikonstrukcione të brendshme si suvatimet, vendosje dyer dritare, punimet elektrike dhe hidrosanitare.

Në përgjithësi ndërhyrjet parashikojnë rehabilitimin e banesave ekzistuese të cilat paraqiten si tepër të amortizuara .

1. Gjëndja aktuale:

Banesat ku jeton komuniteti egjyptian në Gramsh janë objekte të vjetra, një katëshe dhe në gjendje tepër të amortizuara.

Ndërtesat janë të ndërtuara në përgjithësi me mure guri me gjerësi të ndryshme .

Çatitë janë me kapriata druri të mbuluara me tjangulla vendi tepër të amortizuara ose me materiale të tjera, eternite, letër katrama, plastmas, llamarina etj.

Shtresat e dyshemeve janë me llustër çimento, pllaka të copëtuara ose tokë e fortë.

Dyert dhe dritaret janë prej lende druri, kompesatë ose lëndë plastike.

Suvatimet kanë humbur funksionin e tyre prej lageshtisë së theksuar dhe në raste të caktuara mungojnë fare.

Të gjithë elementet e çatisë dhe tavanet janë tepër të amortizuara dhe kanë nevojë emergjente

për ndërhyrje.

Nëpërmjet këtij projekti realizohet rikonstrukcioni i 9 banesave duke u siguruar banorëve kushte më të mira jetese. Realizimi i këtij financimi u jep mundësinë banorëve që në të ardhmen të kryejnë pjesë pjesë punimet e tjera të nevojshme , duke bërë që banesa të jetë në funksion të plotë.

Foto të gjendjes aktuale:



Ish Reparti Ushtarak – Lagjia “Sporti 1”



Ish Reparti Ushtarak – Lagjia “Sporti 1”



Ish Reparti Ushtarak – Lagjia “Sporti 1”



Lagjia “Holta



Lagjia "Holta"

Projekti parashikon rehabilitimin e pjesshëm të banesave, kryesisht të:

1. Ndërtimin e çatave të reja;
2. Ndërtimin e tavaneve të reja;
3. Hidroizolimim të soletave;
4. Dyer druri të brendshme e të jashtme;
5. Dritare duralumini;
6. Shtresa me pllaka dysHEMEJE;
7. Suvatime të brendshme dhe të jashtme;
8. Instalime elektrike;
9. Instalime hidrosanitare.
10. Shtesa anesore të objekteve ekzistuese
11. Ndërtim i ri

Disa foto nga gjendja aktuale e banesave:



Adresa :Sheshi "Kamber Dermyshe" Bulevardi "10 Korriku"Tel.Fax: +51322272,Email:bashkiagr2004@gmail.com



Adresa : Sheshi "Kamber Dermyshe" Bulevardi "10 Korriku" Tel. Fax: +51322272, Email: bashkiagr2004@gmail.com



Për çdo banesë janë hartuar planimetritë dhe preventivat përkatës të punimeve të parashikuara. Preventivi është hartuar në bazë të çmimeve të manualit të miratuar me VKM Nr. 629 datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”

HARTOI

PËRGJEGJËSE

E DREJTORISË SË PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

Ing. Manjola ÇEKREZI